



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Të nderuar qytetarë të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ju njofton se nga **20 marsi** ka filluar periudha për aplikim për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës, e cila përfundon më **27 mars 2023**.

Për ta fituar të drejtën e votimit përmes postës, ju duhet që:

- Të jeni nga **mosha 18-vjeçare** në ditën e votimit, **më 23 prill 2023**;
- Të jeni **shtetas i Republikës së Kosovës** dhe të keni dokument të identifikimit të Republikës së Kosovës; dhe
- Të dëshmoni se keni të drejtë **për t'u regjistruar si shtetas i Republikës së Kosovës**.

Formularin për regjistrim për Votim Përmes Postës mund ta siguronit nga:

- Ueb faqja e KQZ-së kqz-ks.org; te linku: "**Shërbimet për Votuesit**", pastaj linku: "**Votimi Përmes Postës**";
- Duke telefonuar në linjën ndihmëse të Operacionit të votimit përmes postës, në numrat:
+ 383 38 213 100
+ 383 38 213 200
- Apo në **Ambasadat dhe konsullatat e Republikës së Kosovës**.

Aplikacionin e plotësuar mund ta dërgoni përmes postës në adresë të KQZ-së:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Votimi Përmes Postës
Posta nr. 6, Kutia Postare 351
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmes e-mailit zyrtar në ndonjërin nga këto e-maila të shërbimit votues:

ovpp@kqz-ks.org dhe
ogpp@kqz-ks.org

Përmes faksit:
+ 383 38 213 200.

Aplikacionet për votim përmes postës **duhet të arrijnë në KQZ deri më 27 mars 2023**.

Nëse ju aplikoni për t'u regjistruar përmes postës elektronike, aplikacionin tuaj duhet ta dërgoni vetëm për vete apo rrethin e ngushtë familjar, përmes postës elektronike personale (e-mailit).

Nëse dërgoni aplikacione për persona të tjerë, aplikacionet për regjistrim do të refuzohen.